

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010), nenit 20 dhe 22 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2014 miratoi si në vijim:

## **RREGULLORE**

### **PËR LICENCIMIN E OFRUESVE TË PENSIONEVE PLOTËSUESE INDIVIDUALE**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore përcakton kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e licensës për Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale ( në vijim Ofruesi i Pensioneve).
2. Kjo rregullore do të zbatohet nga BQK-ja për të gjithë aplikuesit për licensë për të themeluar Fond të Pensioneve në Republikën e Kosovës.

#### **Kreu I**

#### **Dispozita të Përgjithshme**

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-168 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-101 Për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit Nr.04/L-101 Për Fondet Pensionale të Kosovës dhe ( në vijmë Ligji për Fondet Pensionale) ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj rregulloreje:

**“I licensuari”** nënkupton subjektin juridik licensuar nga BQK-ja sipas Ligjit për Fondet Pensionale dhe kësaj Rregullore.

**“Pension”** nënkupton pagesën e rregullt mujore për një pjesëmarrës gjatë tërë jetës, duke filluar nga moshja e pensionimit, paaftësia fizike ose vdekja e pjesëmarrësit konform Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.

**“Pension plotësues individual”** – nënkupton një pension për një person individual fizik i blerë nga ofruesi i pensioneve siç është një institucion financiar, bankë, menaxhues i mjeteve ,instrument për investime të hapura ose kompani e sigurimeve dhe i siguruar sipas këtij ligji

“**Aksionari kryesor**” nënkupton aksionarin ose pronarin përfitues të 10% ose më shumë aksioneve të barabarta të licensuarit.

“**Institucione financiare**” nënkupton bankat, kompanitë e sigurimeve, institucion financiar për menaxhimin e një fondi të pensioneve me kontribut të caktuar, kompanitë për instrumente dhe investime të hapura.

### **Neni 3**

#### **Veprimtaria e Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale**

1. Vetëm Institucionet Financiare sipas kësaj rregulloreje mund të ofrojnë Pensione Plotësuese Individuale ( me tej Ofrues të pensioneve).
2. Askush nuk mund të ushtroj veprimtari të Ofruesve të Pensioneve në Republikën e Kosovës pa siguruar paraprakisht licence nga BQK-ja.
3. Ofruesit e pensioneve të licencuar do t’i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes nga ana e BQK-së.

### **Kreu II**

#### **Kriteret për Licencim te Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale**

### **Neni 4**

#### **Kërkesat për aplikim**

1. Të interesuarit për licencë për Ofrues të Pensioneve duhet të përmbushin të gjitha kërkesat sipas Ligjit për Fondet Pensionale, që janë të nevojshme për procesin e aplikimit sipas akteve të brendshme të BQK-së. Aplikuesi mund të kërkojë format e nevojshme të aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre nga BQK-ja apo të njëjtat mund t’i gjejë në webfaqen zyrtare të BQK-së.
2. Aplikacioni nënshkruhet nga themeluesi/t dhe dorëzohet në BQK, me prezencë fizike të përfaqësuesit të themeluesit të Ofruesit të Pensioneve të propozuar. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Fondet Pensionale dhe me këtë Rregullore.
3. Dokumentacioni i ofruar duhet të jetë në një nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar

### **Neni 5**

#### **Kriteret për Licencim**

1. Institucionet Financiare, të cilat aplikojnë për licencim si Ofrues të Pensioneve përveç kërkesave të nenit 22 të Ligjit për Fondet Pensionale, duhet t’i plotësojnë kriteret, si në vijim:
  - a. të jetë i regjistruar si person juridik në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;

- b. të jetë në gjendje të mirë financiare të dëshmuar me pasqyra financiare të audituara dhe të mos ketë obligime tatimore të papaguara;
  - c. drejtorët dhe menaxherët e ofruesit të pensioneve të propozuar të mos jenë të dënuar për ndonjë veprë penale dhe t'i plotësojnë kërkesat e BQK-së për i "përshtatshëm dhe i duhur";
2. Kërkesës për licencim si Ofrues i Pensioneve duhet ti bashkëngjitet dokumentacioni në vijim:
- a. formulari i BQK-së;
  - b. kopja e licencës dhe regjistrimit si institucion financiar;
  - c. biografite e plotat të themeluesve, si dhe pasqyrat financiare nëse janë të aplikueshme,
  - d. listën e anëtareve të propozuar për bordin e drejtorëve dhe menaxherëve, biografite e plotat të tyre, duke përfshirë dëshmitë që vërtetojnë përgatitjen dhe përvojën relevante;
  - e. struktura organizative (organo gramim);
  - f. statutin;
  - g. kopjen e regjistrimit të biznesit si ofrues i pensioneve;
  - h. plani i biznesit;
  - i. plani pensional;
  - j. opinionin e një eksperti të pavarur/aktuarit që konfirmojnë ekzistencën e vlerësimit dhe vërtetojnë se kontributet e kërkuara janë adekuate për të paguar pensionet, në rast të Fondit të Pensioneve me Benefit të Definuar;
  - k. përshkrimi i kategorive të pensioneve që do të ofrojnë në treg, dhe kopja e kontratës (ve) individuale të pensionit ose dokument (të) ekuivalente që evidentojnë pjesëmarrjen e individit;
  - l. pasqyrë mbi sistemin e menaxhimit të rrezikut të siguruar nga ofruesit e pensioneve për funksionimin e biznesit të pensioneve;
  - m. raport të ofruesit të pensioneve për politiken e investimeve;
  - n. kopja marrëveshjes për mbajtësin dhe menaxhuesin e mjeteve nëse aplikanti nuk është i licensuar si Menaxhues i Mjeteve ose Mbajtës i Mjeteve Pensionale;
  - o. lista e pjesëmarrësve që tregojnë kategoritë e tyre profesionale, ose deklaratat e të

- gjithë nënpunesave të Sponsorit që do të marrin pjesë;
- p. emri dhe detalet kontaktuese të firmës audituese për Ofruesin e Pensioneve;
  - q. dokumenti që vërteton se ofruesi i pensioneve i propozuar disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë si Fond Pensional, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK;
  - r. dëshmi të pagesës së tarifës së licencës në bazë të numrit të pjesëmarrjeve;
3. Për veç kërkesave të lartcekura BQK-ja mund të kërkoj informata apo dokumentacion shtesë.

### **Neni 6** **Refuzimi i dhënies së licencës**

BQK mund të refuzoj dhënien e licencës në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 22 të Ligjit për Pensione.

### **Neni 7**

#### **Kërkesat për Institucionet Financiare të huaja**

1. Institucioni financiar i huaj i cili aplikon për të kryer veprimtari të Ofruesit të Pensioneve në Kosovë, përveç kushteve të kësaj rregullore duhet të plotësojnë edhe kërkesat si më poshtë:
  - a. dëshmi prej autoritetit mbikëqyrës ose rregullator të shtetit amë të aplikantit që konstaton se aplikanti është në “gjendje të mirë” dhe në “pajtim” me të gjitha ligjet dhe kërkesat rregullatorë në atë juridiksion të huaj;
  - b. dëshmi mbi licencimin e saj nga rregullatori bankar, shërbimet financiare dhe tregjet e kapitalit rregullator të një shteti anëtar të OECD-së dhe BE;
  - c. dëshmi që vërteton gjendjen financiare e audituar për 5 vitet e fundit. Aty ku aplikohet, gjithashtu duhet të parashtrohet gjendja financiare e kompanisë amë të aplikantit dhe kompanitë e afërta për 5 vitet e kaluara;

### **Neni 8**

#### **Afati i shqyrtimit të kërkesës për licencim të Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale**

1. BQK bën shqyrtimin e dokumenteve të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore.
2. BQK nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon kërkesën për licencë si Ofrues i Pensioneve brenda 90 ditëve nga data e pranimit të kërkesës për licencë. Për vendimin e

marr BQK menjëherë e informon aplikantin

3. Data e pranimit të kërkesës për licencë konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat e kësaj rregullore. Kjo datë i njoftohet me shkrim kërkuetit, nga BQK-ja .
4. BQK-ja brenda 30 ditë pas datës së pranimit të aplikacionit e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikantin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar.
5. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuar me këtë rregullore, BQK e njofton për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e kësaj rregullore se bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacionin shtesë.
6. BQK ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencë nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 1 muaj pas njoftimit të BQK-se sipas paragrafit 5 te këtij neni. Në rast të ndërprerjes së procedurës se shqyrtimit te kërkesës/aplikacionit për licencë, BQK e njofton me shkrim aplikuesin.

### **Neni 9**

#### **Tarifat për Licencimin e Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale**

1. Aplikuesi që kërkon licencë si Ofrues i Pensioneve duhet të paguaj tarifat e licencimit dhe të mbikëqyrjes së Pensioneve në shumat e aprovuara nga BQK-ja.
2. Tarifa e aplikimit për licencë nuk rimburohet edhe në rast të refuzimit të kërkesës për licencë nga BQK-ja.

### **Neni 10**

#### **Karakteristikat e Licencës**

1. Licenca jepet me shkrim për një periudhe të pacaktuar kohore, dhe nuk është e transferueshme.
2. Nëse brenda 12 muajve nga data e licencimit, Ofruesi i Pensioneve nuk e fillon veprimtarinë, licenca do të revokohet.

### **Kreu III**

#### **Pezullimi dhe Anulimi i Licencave për Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale**

### **Neni 11**

#### **Kushtet dhe Procedurat për Anulimin e Licencës së Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale**

1. Përveç kushteve të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit për Pensione BQK-ja mund të anulohet licencën duke u bazuar në ndonjërin prej kushteve si vijojnë:

- a. përsëritje e shkeljeve, ose shkelje të lartë nga i licencuari, Menaxhuesi i Mjeteve të tij ose Mbajtësit, të kërkesave të Ligjit për Pensione, apo ligjeve të aplikueshme, ose rregulloreve BQK-së.
  - b. përsëritja e shkeljeve të afatit kohor, të përcaktuar nga BQK-ja për korrigjim e shkeljeve në aktivitetet e të licencuarit, të cilat kanë qenë bazë për pezullimin e licencës.
  - c. përsëritja e shkeljeve të afatit kohor të përcaktuar nga BQK-ja për raportimin mbi aktivitetet e të licencuarit.
  - d. dështimi i të licencuarit për kohën gjatë një viti që të përmbushë funksionet e ndërmarra për të siguruar pensionet.
  - e. likuidimi ose përfundimi i të licencuarit.
  - f. njohja e bankrotimit të licencuarit.
  - g. për arsye të tjera, të përcaktuara me rregulloret e aplikuara ose udhëzimeve të lëshuara nga BQK-ja në lidhje me Ligjin për Fondet Pensionale të Kosovës ose ligjeve të aplikueshme.
2. Menjëherë pas marrjes së vendimit për anulim të Licencës BQK do ta njoftojë me shkrim të licencuarin se licenca e tij është anuluar. Njoftimi duhet të paraqet kriteret e anulimit dhe ndalimit të zhvillimit të ndonjë aktiviteti për të cilin është lëshuar licenca. Gjithashtu njoftimi duhet t'i paraqitet Mbajtësit dhe Menaxhuesit të Mjeteve. Anulimi bëhet efektiv në pajtim me afatin kohor dhe mënyrën e përshkruar në Nenin 24 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës.
  3. Në rast se licenca e tij është anuluar, Ofruesi i Pensionit është i obliguar të prezantoj të gjitha shënimet dhe dokumentet që i takojnë mjeteve të pensioneve brenda afatit dhe procedurave vijuese të përcaktuara me rregulloret e Pensionit përveç nëse BQK-ja në interes të pjesëmarrësve dhe përfituesve, urdhëron një kohë më të hershme ose mënyrë tjetër për tu kryer një prezantim i tillë.
  4. Procedura e përfundimit të Ofruesit të Pensionit pas marrjes së vendimit për anulim të licencës do të zbatohet sipas dispozitave të nenit 24 të Ligjit për Pensione.

## **Neni 12**

### **Kushtet dhe Procedurat për Pezullimin e Licencës**

1. Në rastet kur BQK-ja vendos të veproj sipas paragrafit 2 të nenit 24 të Ligjit për Pensione, mund të pezullojë licencën duke u bazuar në ndonjërin prej kushteve si vijojnë:

- a. shkelja e kërkesave të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, ligjeve tjera të aplikueshme dhe rregulloreve të BQK-ja nga Ofruesit e Pensioneve.
  - b. dështimi për të vepruar në pajtim me Rregulloren e Pensionit.
  - c. dështimi për të lidhur marrëveshje me menaxhuesin e mjeteve dhe/ose marrëveshjen me mbajtësin e mjeteve nëse Siguruesi i pensioneve nuk është i autorizuar që të veproj si Menaxhues i Mjeteve apo Mbajtës i Mjeteve.
  - d. dështimi për të vepruar në pajtim me kërkesat e BQK-së në lidhje me pushimin dhe heqjen dore nga shkeljet brenda kohës së përshkruar nga BQK-ja, duke përfshirë edhe dështimin për të respektuar afatin kohor për korrigjim ose përmirësim të ndonjë shkelje të tillë.
  - e. nëse Licenca është marrë në bazë të ndonjë falsifikimi me qëllim, apo informacionit të rrejshëm të paraqitur nga ose që ka të bëjë me paraqitësin e kërkesës.
  - f. dështimi për sigurimin e raporteve në afatin të kërkuar nga BQK-ja.
  - g. mos pajtueshmëria me kërkesën e BQK-së për informatat kur shqyrton aktivitetet për të licencuarit.
  - h. pezullimi i licencës së të licencuarit si një kompani siguruese, bankë ose institucion financiar.
2. Brenda 2 ditëve të punës pas marrjes së vendimit për pezullim të licencës BQK, do ta njoftoj me shkrim Ofruesin Pensioneve si vijon:
    - a. përshkrimin e shkeljes që caktojnë kriteret për pezullimin e licencës.
    - b. marrjen e masave të nevojshme për të korrigjuar ose përmirësuar ose shkeljen.
    - c. periudhën kohore, brenda së cilës shkelja duhet të korrigjohet ose përmirësohet si dhe dokumentet përkatëse që duhen të sjellën në BQK për t'u bërë korrigjimi dhe përmirësimi.
    - d. lista e aktiviteteve që janë të ndaluara gjatë periudhës së pezullimit.
  3. Brenda 2 ditëve të punës nga marrja e vendimit për pezullimin e licencës së Ofruesit të Pensioneve do të informohet Mbajtësi dhe Menaxhuesi i Mjeteve nëse aplikohet.
  4. Pas marrjes së vendimit për anulim të licencës së Ofruesit të Pensioneve Plotësuese Individuale, procedurat zhvillohen sipas dispozitave të nenit 24 të Ligjit për Fondet Pensionale.

### **Neni 13** **Shqyrtimet Gjyqësore**

Ofruesi i Pensioneve mund të apeloj në gjykatën kompetente kundër vendimit të BQK-së

për refuzim, pezullim ose anulimit të licencës.

**Neni 14**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore do të shfuqizohet Rregulla 2 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Licensimin e Pensioneve Plotësuese Individuale të datës 2 Maj 2002.

**Neni 15**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi me datë 5 janar 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore

---

Bedri Peci